



PRISHTINË - PRIŠTINA  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0275**

**Data e Vendimit: 24.05.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 15/05/2023 për tërheqje nga ankesa të parashtruar nga OE “AWA SH.P.K., me nr. 2023/0275 kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me paisje rekuizita sportive dhe paisje te tjera për IEAA” me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën:24/05/2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet, kërkesa e datës 15/05/2023, e parashtruar nga AWA SH.P.K., për tërheqjen e ankesës me nr. 2023/0275, e datës 15/05/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me paisje rekuizita sportive dhe paisje te tjera për IEAA”, me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

2. I lejohe, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me paisje rekuizita sportive dhe paisje te tjera për IEAA”, me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31.4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

4. Obligohet OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "AWA" SH.P.K me 15/05/2023, kishte parashtruar ankesë në OSHP (Nr. të protokollit 2023/0275) kundër vendimit për dhënie kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje te tjera për IEAA" Nr. Të prokurimit 616-23-1280-1-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK), duke pretenduar në shkelje të neneve: 1, 5, 7, 28, 52, 59, 60, 69 të LPP lidhur me nenin 60 të Rregullores për Prokurim Publik.


OE "AWA" SH.P.K, me 15.05.2023 në sistemin e-prokurim ka tërhequr ankesën me numër 2023/0275, ankesë e cika ka qenë e parashtruar në të njëjtën dite, pra me datë 15.05.2023.

Zyra për pranim dhe shqyrtim të ankesave, pas verifikimit në sistemin elektronik e-prokurimi tek rubrika e-ankesat dhe ankesat e dorëzuara ka konstatuar se ankesa e lartcekur është tërhequr nga OE ankues me datë 15.05.2023.

Kryetarja e OSHP pas informimit lidhur me kërkesën e tërhequr nga operatorit ekonomik në këtë fazë ankues "AWA" SH.P.K, mori vendim me të cilin e aprovon kërkesën e Ankuesit për tërheqje nga ankesa respektivisht pretendimet ankimore të ankesës Nr. 2023/0275 të datës 15.05.2023.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa në këtë fazë (të njëjtën ditë të parashtrimt të saj), duke u bazuar në nenin 31.4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës. Obligohet OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP, në afat prej gjashtëdhjetë (60) të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AWA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: